



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 44, dt. 23.02.2016**

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.02.2016, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, për zhvendosjen e pllakës së varrit-nr.3, (pjesë e Varreve Monumentale në Selcën e Poshtme, Pogradec), për në ambjentet e Muzeut Arkeologjik Korçë, si masë mbrojtëse ndaj tentativave për grabitje që i është bërë këtij objekti vazhdimisht, propozim i diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e propozimit për zhvendosjen e pllakës së varrit-nr.3 dhe pjesës së portës prej guri të varrit nr.5, për në ambjentet e Muzeut Arkeologjik Korçë.  
Pllaka e varrit nr. 3 të zëvendësohet në vend me një riprodhim sipas origjinale.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**